

VENDIM
Nr. 579, datë 28.8.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM NOTASH,
TË MARRËVESHJES SË HUAS, TË DATËS 16 JANAR 2014, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BANKA), PËR
PROJEKTIN E INVESTIMEVE NË SEKTORIN E UJIT (HUAJA NR.8323-AL),
NJOFTIMI I KORRIGJIMIT - RIALOKIMI I TË ARDHURAVE TË HUAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes së huas, të datës 16 janar 2014, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), “Për projektin e investimeve në sektorin e ujit (Huaja nr. 8323-AL), njoftimi i korrigjimit - rialokimi i të ardhurave të huas”, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
IBRD- IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praierstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtoreshë Rajonale, | Rajoni i Ballkanit
Perëndimor,
Evropës dhe Azisë Qendrore

Shkëlqesisë së Saj Anila Denaj
Ministre
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
SHQIPËRI

11 mars 2019

E nderuar Znj. Ministre

Projekti i investimeve në sektorin e ujit
(Huaja nr. 8323-AL)
Njoftimi i korrigjimit - rialokimi i të ardhurave të Huasë

Ne i referohemi (a) Marrëveshjes së Huasë të datës 16 janar 2014, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), për Projektin e Investimeve në Sektorin e Ujit (Projekti); (b) njoftimit të fundit të dërguar nga Banka Botërore tek Huamarrësi, në datën 21 shkurt 2019, cakton datën e re të mbylljes dhe alokimin e të ardhurave të huasë; dhe (c) shkresës suaj të datës 26 shkurt 2019, me të cilën i kërkon Bankës Botërore të korrigjojë dhe rishikojë shumat e alokuara për shpenzimet e pranueshme sipas Projektit.

Si rrjedhojë, me anë të kësaj shkrese, Banka Botërore kryen rialokimin e të ardhurave të Huasë së alokuar në tabelën në seksionin IV.A.2, të Skedulit 2, të Marrëveshjes së Huasë, siç përcaktohet në shtojcën e kësaj letre.

Me respekt

Linda Van Gelder
Drejtoreshë Rajonale, Rajoni i Ballkanit Perëndimor
Evropës dhe Azisë Qendrore

Shtesa

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

Shkëlqesisë së Saj Anila Denaj 11 mars 2019

Shtesë

Tërheqja e të ardhurave të Huasë

Kategoria	Shuma e alokuar e Huasë shprehur në EURO	% e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
(1) Punimet	53,416,000	100%
(2) Mallra, Shërbimet e jo-konsulencës	3,406,000	100%
(3) Shërbimet e konsulencës dhe trajnimit	5,217,750	100%
(4) Shërbimet Operative	304,000	100%
(5) Tarifatat Fillestare	156,250	Shuma e pagueshme sipas seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE		62,500,000

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

Shkëlqesisë së Saj Anila Denaj 11 mars 2019

Në vëmendje të: Z. Erion Luci, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;
Z. Hantini Bonati, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;

Znj. Lindita Sotiri, Këshilltare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
Z. Florian Mustafaraj, Kordinator Projekti WIS , Drejtor i Njesisë së Zbatimit të
Projekteve;
Znj Majlinda Dhuka, Zëvendës Sekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e
Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Qeverisje të Mirë;
Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore.

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701